



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:039220

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05374560

A.nr.399/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe me bashkëpunëtoren profesionale Erbleta Shala, në konfliktin administrativ të paditësit N. J. nga Sh., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B. Q., avokat nga F., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe viktimave civile, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit 06-01/1583 të datës 13.01.2022, me kërkesë për njohjen e së drejtës në pensionin Invalid i luftës dhe kompensimin e pensioneve të papaguara, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 13.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit N. J. nga Sh., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B. Q. avokat nga F...

II. ANULOHET vendimi i të paditurës Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, 06-01/1583 i datës 13.01.2022 i shkallës së dytë dhe vendimin e datës 09.07.2018 të shkallës së parë, dhe paditësit nga data 26.09.2023, të njihet e drejta në pensionit të invalidit të luftës me shkallë të invaliditetit në grupin e VII me përqindje 20% të dëmtimit trupor, në shumën prej 225€ (dyqind e njëzetë e pesë euro).

III. DETYROHET e paditura, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, që paditësit t'i kompensojë

në mënyrë retroaktive pagesën në emër pensionit të invalidit të luftës në shkallë të invaliditet 20% te dëmtimit trupor-në grupin e VII, për periudhën kohore që nga data e refuzimit të kërkesës për aplikim të pensionit të invalidit të luftës datë 21.12.2017 deri me datën 20.12.2023 dhe atë në shumën e pensioneve mujore për diferencën e pensionit 16,825.00 € (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzetë e pesë euro e zero cent) dhe kamatën prej 8% sipas LMD-së në shumën prej 3,907.04€ (tremijë e nëntëqind e shtatë euro e katër cent), shumën nga vendimet e Qeverisë si ndihmesë për tejkalim të krizës, shumën prej 400€ (katërqind euro) e gjithsej shuma e përgjithshme 20,732.04€ (njëzetëmijë e shtatëqind e tridhjetë e dy euro e katër cent), krejt këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit me detyrim

IV. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt, si dhe në prezencën e ekspertes financiare E.. A..

Paditësi me padinë e datës 25.02.2022, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Pohon se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore, se në procedurën që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike. Shton se i njëjti gjatë luftës ishte plagosur nga një plumb i llojit “Dum-Dum” i armës Pragë, me ç’rast ka pësuar plagë eksplozivi në regjionin oxipital të djathtë. I propozon gjykatës që të aprovohet padia si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurës dhe paditësit t’i njihet e drejta në pensionin Invalid i Luftës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit deklaroi: *“Ekspertizën e kemi pranuar me kohë sa i përket ekspertizës në raport me të njëjtën për ekspertin nuk kemi as pyetje dhe as*

vërejtje. Shtojmë se ngelemi pranë precizimit të kërkesëpadisë në kuptimit objektiv të dt.12.01.2024, e cila precizimi është bërë konform ekspertizave mjekësore”.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: “Pas administrimit të provave si në shkresat e lëndës e posaçërisht ekspertizave mjekësore të bëra në këtë qështje, tani është vërtetuar se kërkesëpadia e paditëse është e bazuar në prova dhe ligj, andaj edhe mbi bazën e kësaj gjykatës i propozojmë që në këtë qështje të bie aktgjykim ashtu siç paditësi kërkesëpadinë e ka precizuar me dt.12.01.2024”.

E paditura me përgjigjen në padi të parashtruar në gjykatë me datë 10.11.2022, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tutje, pohon pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të lëndës, i'a ka refuzuar ankesën paditësit si të pabazë nga fakti se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dokumentacionit që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit të shkallës së parë ngase ligjërisht nuk i takon për faktin se pas nënshtrimit të komisionit mjekësor në seancat e rregullta mjekësore është refuzuar nga ana e dy komisioneve mjekësore në bazë të shkresave mjekësore që i ka prezantuar pala dhe të cilat ndodhen në lëndë, prandaj i propozon Gjykatës që pas administrimit të provave të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pabazuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi i dt. 13.01.2022, vendimi me nr. 06-01/1583 dt.30.07.2018, vërtetimi i dt. 22.07.1999, Vërtetimi i dt. 22.07.1999, vërtetimi i dt. 25.01.2009, vërtetimi me numër protokolli 01/07 dt.28.01.2010, Dëshmia me numër protokolli 007/129/011 pa datë, Certifikata e Veteranëve e UÇK-së, me numër protokolli 1/5277 dt.18.03.2016, Vërtetimi për Veteran, Invalid i UÇK-së me numër 2059/2017 dt. 05.12.2017, Kërkesa për vlerësim të shkallës së invaliditetit dt.25.06.2018, Ankesa e dt.21.11.2018, shkresë- formular i shqyrtimit të lëndëve pas kthimit nga gjykata dt.20.12.2021, Vërtetim me numër 07/07/191 dt.01.02.2010, Vërtetimi i lëshuar nga Gjeneral Shukri Buja, Komandant i Zones Operative të Nerodimes pa datë, Vendimi i MPMS-së dt. 09.07.2018, Certifikata e lindjes e paditësit N.. J.. dt.11.12.2017, certifikata e lindjes e H.. P..dt. 11.12.2017, certifikua e martesës me numër serik M10475966 dt.11.12.2017, certifikata e lindjes e K.. J.. dt. 11.12.2017, certifikata e lindjes e N.. J.. dt. 11.12.2017, certifikata e lindjes e A.. J..dt. 11.12.2017, Raporti nga konsulta dt. 18.12.2017, Raporti nga Ambulanta e Pavarur Kirurgjike “Jeta” dt. 29.08.2007, Raport i QKUK-së dt. 19.12.2017, Udhëzimi i mjekut specialist dt. 27.01.2010, Fletë lëshimi nga QKUK dt.10.12.2008, Raport i QKUK në Prishtinë

dt. 26.01.2010, Udhëzimi i mjekut specialist dt. 26.01.2010, Raporti nga Konsulta data nuk shihet qartë, Ankesa e dt. 30.07.2018, Vendimi i MPMS dt. 07.12.2018, Formulari për Invalidë të Luftës me nr.06-01/1583 i dt. 21.12.2017, ekspertiza mjekësore e dt.26.09.2023, ekspertiza financiare e dt.20.12.2023 si dhe ky procesverbal i sotëm i dt.12.02.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43.3 dhe 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative ashtu që vendosi që vet meritorisht ta vendos këtë çështje administrative. Gjykata duke vlerësuar e vendimin e goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thëniet e padisë, përgjigjes së dhënë nga e paditura ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Nga vendimet e kontestuara del se ato përmbajnë të meta të tilla, për shkak të të cilave, nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se, me nenin 48 të LPPA-së është paraparë mënyra e arsytimit e cila konsiston në faktin që arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi duhet të përmbaj paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. Pra një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Nga provat e administruara dhe atë nga vendimi i të paditurës për pension të invalidit të luftës, të datës 13.01.2022, gjykata vëren se paditësit i është refuzuar kërkesa për këtë kategori të pensionit. Ndërsa, me këtë vendimin të të paditurës, të goditur me padi, arsyetohet se është refuzuar ankesa në bazë të Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe të Viktimave Civile të Luftës.

Gjykata gjeti se me Aktgjykimin A.nr.58/19 të datës 08.11.2021, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, palës paditëse i kishte aprovuar padinë e tij duke anuluar vendimin paraprak të të paditurës dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje tek e

paditura, ndërsa, e paditura përsëri me vendimin kontestues të goditur me padi ka refuzuar të drejtën për njohën e këtij pensioni.

Me qëllim të vendosjes meritorë në këtë çështje juridike administrative, gjykata duke u bazuar në neni 43, paragrafin 3 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe për të vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje, konform nenit 21 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësim të LPK-së nr.04/L-118 e lidhur me nenin 16 dhe 18 të Rregullores nr.15/2015 për emërimin e ekspertëve gjyqësor, me propozimin e përfaqësuesit të palës paditëse ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore. Me vendimin e Gjykatës janë caktuar ekspertë mjekësor për dhënien e mendimit profesional në përbërje të Dr. I. K.-Kirurg etj. Në këtë gjykatë është dorëzuar mendimi profesional i ekspertëve, ku është dhënë vlerësimi me konstatimin se paditësi ka 10% invaliditet në fushën e Kirurgjisë dhe 10% të invaliditetit në fushën e Psikiatrisë, e në total përbën shkallën e invaliditetit prej 20%.

Gjykata po ashtu, me qëllim që të përcaktohet vlera e saktë e kompensimit e cila duhet të paguhet nga data e refuzimit së këtij pensioni, me kërkesën e përfaqësuesit të palës paditëse me aktvendimin A.nr.399/2022 të datës 11.12.2023, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare e cila i është besuar Ekspertes gjyqësore financiare E.. A..

Pas administrimit të provave si më lartë dhe vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjykatai i fali besimin raporteve mjekësore të administruara në seancë, me të cilat konstatohet se si paditësi hyn në kategorinë e invalidëve të luftës dhe atë në përqindje 20% të dëmtimit trupor në grupin e VII. Në veçanti, Gjykata krijoi bindjen e saj nga ekspertiza mjekësore e datës 26.09.2023 e nxjerrë nga grupi i ekspertëve mjekësor gjyqësor, në të cilën ekspertët kanë arritur në përfundim, se në bazë të dokumentacionit dhe ekzaminimit direkt të paditësit, konstatojmë se i njëjti ka shkallë të invaliditetit në shkallë 20%. Mbi bazën e këtij konstatimi, gjykata erdhi në përfundim të qartë se paditësi hyn në kategorinë e invalidëve të luftës në grupin e VII e përcaktuar në nenin 9 Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe të Viktimave Civile të Luftës.

Nga shkresat e lëndës shihet dhe vërtetohet se gjendja e tij shëndetësore nuk ka ndryshuar, dhe këtë fakt e vërtetoi edhe ekspertiza e eksperteve mjekësor gjyqësor e datës 26.09.2023 dhe deklarimi i ekspertëve në procedurën gjyqësore. Për të gjitha këto arsye, gjykata nuk mundi t'i

falë besimin mendimit dhe konstatimit të komisioneve mjekësore të së paditurës, si provë e vetme me të cilat e njëjta pretendon një gjendje faktike ndryshe nga ajo e konstatuar nga ana e ekspertëve mjekësor gjyqësor përmes ekspertizës mjekësore. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Për të shqyrtuar ligjshmërinë e aktit kontestues të paditurës gjykata ju referua nenit 5 paragrafi 1.2.1, të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe të Viktimave Civile të Luftës është përcaktuar që: *“1. Në përputhje me njohjen dhe përcaktimin e statusit për kategoritë e dala nga luftë, pensionet e përcaktuara në këtë ligj janë: {...} 1.2. Pensioni invalidor personal të cilin e realizojnë: 1.2.1. invalid i UÇK-së”*.

Neni 9 i këtij Ligji përcakton se: *“1. Invalidët e UÇK-së, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me këtë ligj, realizojnë këto të drejta dhe beneficione: 1.1. të drejtën në pensionin invalidor personal, ...”*, në vazhdim neni 10, parasheh: *“Me qëllim të realizimit të të drejtave dhe beneficioneve, në përputhje me shkallën e invaliditetit dhe përqindjen e përcaktuar të dëmtimit trupor, invalidët e UÇK-së ndahen në tetë (8) grupe: 1.1. Grupi I - invalidët me 81% deri 100% të dëmtimit trupor; 1.2. Grupi II - invalidët me 71% deri 80% të dëmtimit trupor; 1.3. Grupi III - invalidët me 61% deri 70% të dëmtimit trupor; 1.4. Grupi IV - invalidët me 51% deri 60% të dëmtimit trupor; 1.5. Grupi V - invalidët me 41% deri 50% të dëmtimit trupor; 1.6. Grupi VI - invalidët me 31% deri 40% të dëmtimit trupor; 1.7. Grupi VII - invalidët me 20 % deri 30 % të dëmtimit trupor; 1.8. Grupi VIII - invalidët me 10% deri 19% të dëmtimit trupor. 2. Vlerësimin mjekësor për shkallën e invaliditetit sipas paragrafit 1. të këtij neni, e bëjnë komisionet mjekësore të Ministrisë, fillimisht në Shkallë të parë me mundësi të ankimit edhe në Shkallën e dytë. 3. Baza e pensionit invalidor personal caktohet sipas Shtojcës 1 të këtij ligji dhe të parashikuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit të vitit 2011. 4. Invalidi i UÇK-së me shkallë invaliditeti 10 deri 19% nuk e gëzon pensionin invalidor personal. 5. Invalidi i UÇK-së me shkallë të invaliditetit mbi 80% ka të drejtë në shtesë për ndihmë dhe kujdes nga personi tjetër, në lartësinë e përcaktuar me Shtojcën 1 të këtij ligji dhe të parashikuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit të vitit 2011. 6. Nëse brenda një familje të ngushtë një nga anëtarët është shfrytëzues i pensionit invalidor personal, anëtarëve tjerë të familjes nuk i'u përjashtohet mundësia e shfrytëzimit të së drejtës në pensionin familjar pas vdekjes së invalidit. 7. Përfituesi, të cilit i është njohur e drejta e pensionit invalidor, nuk e përjashton të drejtën e anëtarëve të ngushtë të familjes për aplikim*

në ndihmë sociale, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.

Prandaj për faktin se paditësi ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata e aprovoi kërkesëpadinë si të bazuar dhe si rrjedhojë e detyroi të paditurën si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, meqë vlerësoi se sa i përket mendimeve dhe vlerësimit të ekspertëve, ekspertiza është e qartë, nuk ka kontradiktë në vete si dhe e paditura nuk e ka kontestuar, nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, madje e paditura nuk i është përgjigjur as ftesave për seancën e shqyrtimit kryesor. Për të gjitha këto arsye, gjykata me qëllim të ekonomizimit të procedurës, respektivisht në respektim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për një proces të rregullt brenda afateve të arsyeshme, nga vlerësimi i përgjithshëm, krijoi bindjen se ekspertiza e nxjerrë nga ekspertet mjekësor, është provë e besueshme, e paanshme për të vendosur çështjen.

Fakti se Republika e Kosovës, në Kushtetutën e saj, neni 22, ka marrë përgjegjësi për zbatimin e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare që kanë për qëllim respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të gjithë personave pa dallime, në këtë kontekst dhe e paditura duke pasur parasysh se kjo kategori e personave ka nevoja të veçanta, është në mandatin e saj të zhvillojë politika dhe të krijojë mundësi të barabarta për këta persona që të gëzojnë shërbime për nevojat e tyre dhe që shkojnë në mbrojtje të dinjitetit të kësaj kategorie, ashtu që të jenë pjesë aktive dhe e dobishme e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës të dhëna në vendimin kontestues dhe përgjigjen në padi, por të njëjtin e refuzoi si të pa bazuar dhe pa argumentuara, këtë bazuar në provat e lartcekura dhe për faktin se vet e paditura ka nxjerrë vendim që mos të i'a njeh këtë të drejtë paditësit, e që nënkupton se e paditura në rastin e paditësit e ka konstatuar gjendjen faktike sa i përket invaliditetit dhe si rrjedhojë kishte aplikuar gabimisht të drejtën material duke mos ja njohur të drejtën e invalidit të luftës.

Ndërsa, me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ është paraparë që *“Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohej edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet”*. Po ashtu e paditura me vendimi e atakuar i'a ka mohuar paditësit të drejtën për shfrytëzimin e pensionit me invalidit të luftës nga refuzimi i kërkesës për realizimin e të drejtës në pension e

invalidit të luftës. Nga kjo rezulton se paditësit në momentin e ekzekutimit të vendimit kontestues i është shkaktuar dëm ngase i njëjti nuk ka mundur të realizoj të ardhurat që kanë buruar nga e drejta në shfrytëzimin të këtij pensioni, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e pensionit, gjykata u bazua në shtojcën e Ligjit nr. 04/l-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe familjeve të tyre) dhe vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/176, të datës 10.03.2014, ku lartësia e këtij pensioni ngritet në 225 Euro për muaj.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, 5 lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 67 Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 63 e lidhur me nenin 21 Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin Ligjit, Nr.03/L-006 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.399/2022, datë: 13.02.2024

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.